



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300342/2

Tiranë ___/___/2023

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në IEVP-në Fushë-Krujë.*

Drejtuar: Z. Admir ABRIJA
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Qazim HOXHA
Drejtor i IEVP-së Fushë-Krujë

FUSH-KRUJË

I nderuar z.Abria,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, si dhe nenin 81 i ligjit 81/2020 "Për të drejtat e dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Fushë-Krujë.

Inspektimi u krye më datë 11.04.2023, sipas planit vjetor të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi, zj.Gloria Çarkaxhiu dhe z.Hazbi Selita, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i vizitës inspektuese ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve dhe kushtet infrastrukturore për jetesë normale, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e RSH, me aktet ligjore kombëtare dhe standardet ndërkombëtare për këtë qëllim. Gjithashtu, inspektimi kishte si qëllim edhe verifikimin e progresit që strukturat

përgjegjëse në IEVP dhe në DPB, kanë bërë për zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së, dërguar përmes raportit me rekomandime më datë 17 Tetor 2022¹.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit të MKPT-së, ka detyrimin ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e inspektimit si më poshtë vijon:

Shënime paraprake

Vizita inspektuese në IEVP Fushë-Krujë, u zhvillua në kuadër të inspektimeve periodike që zhvillon MKPT në institucionet ku privohet liria e personit, në mënyrë të pa paralajmëruar në bazë të kompetencave të parashikuara në ligjin nr.81/2020 “Për të drejtat e dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Bazuar në metodologjinë e inspektimit, grupi i MKPT-së zhvilloi takim me drejtorin e institucionit z.Qazim Hoxha dhe shefin e policisë z.Fatjon Sadikaj, të cilët u vunë në dijeni në lidhje me qëllimin e vizitës inspektuese.

Drejtuesit e institucionit informuan për respektimin e të drejtave të të burgosurve, plotësimin e kushteve infrastrukturore në regjimin e brendshëm, si dhe për aktivitetet që zhvillohen me të burgosurit me qëllim rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, grupi i inspektimit u informua edhe në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm.

Bazuar në urdhër nr.381, datë 19.07.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për disa ndryshime në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 “Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, IEVP Fushë-Krujë kategorizohet “burg i sigurisë së zakonshme”, me një seksion për të dënuarit siguri e zakonshme dhe një seksion paraburgimi.

Kapaciteti fizik i institucionit, referuar parametrave teknikë të ndërtimit të godinave të banimit, është për mbajtjen e 380 të burgosurve². Në momentin e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm **ndodheshin 370 të burgosur**, nga të cilët 300 të paraburgosur dhe 70 të dënuar me vendim të formës së prerë.

Për shkak të numrit të lartë të të paraburgosurve, institucioni ka rritur numrin e krevatëve në dhomat e banimit në këtë sektor, duke shkelur kriteret dhe kushtet për persona i takon kubaturës dhe sipërfaqes së lejueshme për person në dhomat e banimit, të parashikuara në aktet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. Kjo situatë cënon cilësinë e jetës të të paraburgosurve në dhomat e banimit, njëkohësisht ndikon edhe në uljen e nivelit të shëndetit fizik, gjendjen psikologjike dhe të shëndetit mendor të të burgosurve, duke përbërë trajtim degradues dhe jo njerëzor të personave që qëndrojnë në këto ambiente³.

¹ Shkresë nr.K4/I37-2 prot., datë 17.10.2022 drejtuar DPB dhe IEVP Fushë-Krujë.

² Urdhër nr.735 prot., datë 04.05.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

³ Neni 3 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Shkelja e këtij standardi, është evidentuar edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) me rastin e vizitës monitoruese në Shqipëri në vitin 2018. Në zbatim të rekomandimeve edhe të KPT-së (CPT), Qeveria Shqiptare ka bërë përmirësime të kuadrit ligjor, duke miratuar në Kuvendin e Shqipërisë “paketën penitenciare 2020”. Midis përmirësimeve të rëndësishme, në ligjin nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, u miratua pikërisht standardi ndërkombëtarë për normën jetike të vendosjes së të burgosurve në ambientet e banimit, duke mbajtur parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale dhe të të burgosurve “...por në çdo rast duke iu siguruar **kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar...**”⁴.

Nisur nga gjetjet e inspektimeve, mbi situatën e popullimit edhe në IEVP-të e tjera, Avokati i Popullit sjell në mënyrë të përsëritur ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rishpërndarjen e drejtë dhe të balancuar të të burgosurve në institucionet e sistemit penitenciar, sipas kategorizimit të IEVP-ve, duke marrë në konsideratë parametrat teknikë të ndërtimit të godinave të banimit. Rritja e numrit të shtretërve në dhomat ekzistuese të banimit, nuk e ul mbipopullimin në IEVP, por rrit në mënyrë fiktive numrin e të burgosurve brenda të njëjtës sipërfaqe banimi. Tërësia e masave që ndërmerren në sistemin e burgjeve, duhet të jetë në drejtim të përmirësimit të jetesës dhe jo përkeqësimit të kushteve të trajtimit dhe kushteve të jetesës të të burgosurve.

Grupi i inspektimit, mori informacion për situatën e popullimit në këtë institucion dhe për periudhën e janar - prill 2023, e cila rezultoi të ishte si më poshtë vijon:

- Janar - 344 të burgosur/268 të p/b dhe 76 të dënuar
- Shkurt - 364 të burgosur/289 të p/b dhe 75 të dënuar
- Mars - 367 të burgosur/297 të p/b dhe 70 të dënuar
- Prill - 370 të burgosur/300 të p/b dhe 70 të dënuar

Në regjimin e brendshëm të IEVP-së, të burgosurit ishin të akomoduar në 2 godina banimi, të ndarë sipas sektorëve. Në godinën “A” ishin akomoduar të dënuarit me vendim të formës së prerë nga gjykatat, ndërsa të paraburgosurit për shkak të numrit të lartë, ishin akomoduar në godinën “B” dhe në katin e parë të godinës “A”. Sipas informacionit të sektorit të logjistikës, kompletimi me shtretër në godinën “A” është e plotësuar me 200 shtretër dhe godina “B” me 262 shtretër, pra në total IEVP Fushë-Krujë është e pajisur me 462 shtretër.

Referuar statistikave, IEVP Fushë-Krujë nuk kishte mbipopullim, por në sektorin ku ishin të akomoduar të paraburgosurit, grupi i inspektimit konstatoi se, në dhomat e banimit ndodheshin 4, 5 dhe 6 persona, për shkak të numrit të lartë të të paraburgosurve.

⁴ Neni 33/4 i ligjit 81/2020.

Pavarësisht kësaj situatë, grupi i inspektimit nuk konstatoi asnjë të paraburgosur të flinte me dyshekë në tokë, por të gjithë ishin të pajisur me krevat dhe materiale fjetje.

Godina për takimet fizike të të burgosurve me familjarët është e ndarë në dy ambiente më vehte, për të paraburgosurit dhe për të dënuarit. Në këtë godinë ndodhen edhe dhomat për takime të të burgosurve me avokatët mbrojtës dhe prokurorët e çështjes. Ndërsa, në godinën e shërbimeve ndodhej kuzhina e institucionit, si dhe ambientet e infermierisë dhe spitalit me shtretër për të sëmurët sipas rekomandimit të mjekut të institucionit. Dhomat e veçimit ndodhen në një godinë më vehte në regjimin e brendshëm, ndërsa godina ku ndodhen dhomat e observimit dhe tranzitit ishte e mbyllur dhe jashtë funksionit, për shkak të dëmtimeve teknike që ka pësuar godina nga pasojat e tërmetit në muajin Nëntor 2019.

Struktura organike e institucionit ishte e miratuar me urdhër nr.43 datë 25.03.2021 të Kryeministrit të RSH “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithëshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve të varësisë së saj”. IEVP Fushë-Krujë kishte në organikë 42 punonjës civil dhe 222 punonjës policie. Aktualisht ishin 38 punonjës civil dhe 212 punonjës policie. Nga informacioni mbi vendet vakante sipas organikës në këtë institucion, rezultoi se:

- **Në stafin civil mungonin 4 punonjës**, zv/drejtori i IEVP-së, përgjegjësi i burimeve njerëzore & shërbimeve, përgjegjësi i sektorit ligjor dhe 1 infermier.
- **Në sektorin e policisë mungonin 10 punonjës**, 4 punonjës të rolit të mesëm (PRM) dhe 6 punonjës të rolit bazë (PRB). Sipas informacionit, mungesat në staf nuk ndikonin në dhënien e shërbimeve dhe sigurinë e të burgosurve, por lind nevoja e plotësimit sa më parë të vendeve vakante.

Nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së në inspektimin e mëparshëm, rezultoi se, ishin realizuar si më poshtë vijon:

- ✓ Ishin lidhur kontratat e punës midis institucionit dhe të burgosurve të punësuar, kundrejt pagesave mujore, sipas kritereve të përcaktuara në VKM-në nr.602, datë 13.10.2021 “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”.
- ✓ Në muajin Qershor 2023, sipas informacionit të DPB-së, fillon zbatimi i projektit për rikonstruksionin e plotë të godinave në regjimin e brendshëm, si dhe kryerja e instalimeve elektrike dhe hidraulike.
- ✓ Sektori i shëndetësisë ishte i kompletuar me 2 mjekë, një mjek i përgjithshëm me kohë të plotë dhe një mjek me kontratë me kohë të pjesëshme, për të garantuar një sistem efektiv të shërbimit shëndetësor të të burgosurve.
- ✓ Ka filluar zbatimi i Udhëzimit të përbashkët i Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.1 datë 22.02.2022 “Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit”, ku parashikohen norma ushqimore ditore më të larta se në udhëzimin e vitit 2006.
- ✓ Ishte siguruar furnizimi pa ndërprerje me energji elektrike i ambienteve të IEVP-së, nëpërmjet vënies në funksionim të linjës së jashtme të furnizimit 20 KW.

Nga inspektimi u evidentua gjithashtu se disa nga rekomandimet nuk kishin gjetur zbatim. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, arsyea ka qenë mungesa e fondeve për investime, si dhe mungesa e burimeve njerëzore për plotësimin e vendeve vakante në organikën e institucionit. Më konkretisht:

- ✓ Në sektorin e paraburgimit, dhomat ishin të mbingakuara me 4 dhe 6 persona, mbi normën e parashikuar për jetesë normale, duke përbërë trajtim jo dinjitoz e degradues të të paraburgosurve.
- ✓ Nuk ishte miratuar ende Rregullorja e Brendshme e institucionit, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- ✓ Nuk kishte të miratuar një urdhër të DPB-së për kapacitetin fizik për secilin institucion të sistemit penitenciar.
- ✓ Nuk ishin afishuar në vende të aksesueshme për të burgosurit numrat e telefonit të Avokatit të Popullit dhe organizatave jo qeveritare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- ✓ Pavarësisht masave të marra nga institucioni për furnizimin me ujë të ambienteve në regjimin e brendshëm, ende vazhdonte praktika e furnizimit ditor me ujë sipas një grafiku të miratuar, për mbajtjen e higjienës personale dhe pastërtinë e ambienteve të përbashkëta.
- ✓ Nuk ishte vënë në funksion kaldaja qendrore, me qëllim përmirësimin e sistemit për ngrohje/ftohje të ambienteve në regjimin e brendshëm.
- ✓ Në ambientet e kuzhinës së institucionit, nuk ishte bërë zëvendësimi i enëve të dëmtuara dhe të vjetëruara si për gatim dhe për shpërndarjen e ushqimit të të burgosurve.
- ✓ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ende nuk ka parë të arsyeshme shtimin e operatorëve privatë telefonik në sisteme burgjeve, gjë e cila do të sjellë shtimin e aparatëve telefonik me kartë në çdo sektorë, si dhe uljen e çmimit në blerjen e kartës nga të burgosurit.
- ✓ Biblotekat e institucionit, nuk ishte furnizuar e me libra të rinj, me qëllim rritjen e interesit të të burgosurve për leximin.

Trajtimi i të burgosurve

Vizita inspektuese në IEVP Fushë-Krujë, kishte për qëllim identifikimin e rasteve të përdorimit të torturës, trajtimit degradues e diskriminues, përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative apo edhe presionit psikologjik ndaj të burgosurve, të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion.

Theksojmë se, nga zhvillimi i intervistave konfidenciale me të burgosurit, grupi i inspektimit nuk konstatoi raste të torturës, trajtimit degradues, diskriminues apo dhe keqtrajtimi nga punonjësit e policisë të institucionit ndaj të burgosurve.

U verifikuan gjithashtu praktikat e punës të sektorit ligjor dhe procedurat që zbatohen nga komisioni i disiplinës të institucionit, në procesin e marrjes të vendimit për dhënien e masave disiplinore të lehta dhe të rënda ndaj të burgosurve, në përputhje me shkeljet disiplinore të kryer nga ana e tyre.

Nga verifikimi i dokumentacionit, rezultoi se rregullat e disiplinës në këtë institucion zbatoheshin në përshtatje me moshën, gjendjen fizike, psikike e psikologjike të të burgosurve, me qëllim stimulimin e ndjenjës së përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të burgosurve, dhe jo duke i konsideruar ato thjesht e vetëm si masa ndëshkuese⁵.

Grupi i inspektimit, vizitoi ambientin e veçimit ku mbahen dhe trajtohen të burgosurit me masë disiplinore, e cila ndodhej në një godinë më vehte në regjimin e brendshëm. Në momentin e inspektimit, nuk ndodhej asnjë i burgosur në dhomat e veçimit. Por, ambienti i veçimit ishte në kushte higjeno-sanitare që linin shumë për të dëshiruar. Në dhoma dhe në korridorin e këtij ambienti, u gjetën materiale fjetje të dëmtuara dhe ushqime të hedhura në tokë, papastërti, dhe në tërësi ambienti ishte i pa lyster dhe i pa dizifektuar. Kjo situatë, duhet të ndryshojë menjëherë, përse kohë nuk lidhet me sigurimin e fondeve dhe kryerjen e investimeve, pasi në gjendjen në të cilën ndodhet sektori i veçimit, mungesa e theksuara e kushteve higjeno-sanitare përbën trajtim jo dinjitoz dhe njerëzor të personave që qëndrojnë në këto dhoma pas ekzekutimit të vendimit të masave disiplinore⁶.

Gjatë inspektimit, u evidentua se kushtet infrastrukturore të godinave të banimit në regjimin e brendshëm, kishin probleme me amortizimin, lagështirën, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, kushtet teknike dhe higjeno-sanitare jashtë standardeve të tualeteve dhe të dusheve, si dhe të pranisë së insekteve në këto ambiente.

Sipas informacionit të drejtorit të institucionit, IEVP Fushë-Krujë do të nënshtrohet një rikonstruksioni të plotë gjatë këtij viti në godinat e regjimi të brendshëm, gjë e cila do të përmirësojë ndjeshëm kushtet e jetesës për të burgosurit. **Projekti për këtë investim do të fillojë në muajin Qershor 2023 dhe do të financohet nga fonde të buxhetit të shtetit.**

Kuzhina e institucionit, ishte përgjithësisht në kushte të mira higjeno- sanitare, por grupi i inspektimit, konstatoi se enët që përdoren për gatim dhe ato për shpërndarjen e ushqimit të të burgosurve, ishin të vjetëruara dhe të dëmtuara, ndaj ato duhet të zëvendësohen menjëherë me pajisje të reja kuzhine. Ky shqetësim është ngritur edhe në inspektimet e mëparshme të MKPT-së, por konstatohet se ky rekomandim, ende nuk ka gjetur zbatim nga sektorët e logjistikës në IEVP dhe në DPB.

Pavarësisht hyrjes në fuqi të urdhërit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe MSHMS, për ndryshimin e normativave të disa produkteve ushqimore, të burgosurit paraqitën

⁵ Nenet 60-67 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

⁶ Neni 88 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve “Shkeljet disiplinore”.

ankesa të përsëritura për mungesën e larmishmërisë të menisë së gatimit dhe cilësinë e ulët të gatimit të ushqimit. Në këto kushte, kishte të burgosur që nuk e konsumonin ushqimin e gatuar nga institucioni, por gatuanin në dhomat e banimit nga ushqimet që dërgonin familjarët e tyre.

Masat mbrojtëse

Mbështetur në metodologjinë e inspektimit në burgje, grupi i monitorimit të MKPT-së, mori informacion dhe administroi kopje të dokumentacionit të praktikave që kishin të bënin me gjëndjen shëndetësore të të burgosurve, vlerësimin e kushteve psiko-sociale të të burgosurve, aktivitetet kulturore e sportive që zhvillohen me të burgosurit, programet e trajtimit individual dhe këshillimet psiko-sociale sipas grupmoshave, aktivitete këto që ndikojnë në rehabilitimin dhe më tej, në ri-integrimin e të burgosurve. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se praktikat e punës të sektorëve mbështetës dhe sektorit të çështjeve shoqërore, ishin të plotësuara sipas rubrikave dhe të firmosura nga stafet dhe antarët e komisioneve respektive të ngritura me urdhër të drejtorit të I EVP-së.

Në lidhje me zbatimin e procedurave për hyrjet e reja dhe pritjen e të burgosurve në institucion, funksiononte Komisioni i Pritjes⁷, ngritur me urdhër të drejtorit të institucionit. Nga verifikimi i praktikave, u konstatua se procedura e pranimit në institucion zbatohet në mënyrë korrekte, sipas ligjit dhe Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, të burgosurit që hyjnë rishtaz në I EVP njihen me rregulloren e institucionit, kryesisht me të drejtat dhe detyrimet e tyre, të drejtat për këshillime dhe përfitimin e asistencës ligjore sa herë që ishte e nevojshme prej tyre, si dhe rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesave dhe ankesave, duke ju vënë në dispozicion materialet respektive. Informacioni për të burgosurin, jepet edhe në formë të shkruar. Regjistrat e dosjet personale të të burgosurve, ishin të plotësuara sipas rubrikave.

U verifikua mënyra e funksionimit të sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve, për marrjen e shërbimeve nga sektorët brenda institucionit, si dhe për menaxhimin e korrespondencave të të burgosurve drejtuar institucioneve të tjera jashtë sistemit të burgjeve. Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve, rezultoi se kërkesat dhe ankesat e të paraburgosurve regjistrohen në një regjistër të veçantë nga sekretaria e institucionit, si dhe ishin të protokolluara⁸.

Të burgosurit pasi plotësonin një formular kërkesë/ankese e dorëzonin te punonjësi i sektorit psiko-social i ngarkuar për çdo sektor. Punonjësi i sektorit psiko-social i dërgonte formularët në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe sipas procedurës i kalonin drejtorit të institucionit. Në varësi të natyrës të kërkesë/ankesës, sektori përgjegjës

⁷ Neni 16 i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve: “Komisioni i pritjes përbëhet nga një përfaqësues i sektorit ligjor, një përfaqësues i sektorit të çështjeve shoqërore, një përfaqësues i shërbimit shëndetësor dhe një përfaqësues i shërbimit të sigurisë”.

⁸ Neni 58 i ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

i ngarkuar nga drejtori i institucionit i kthente përgjigje me shkrim, ose drejtori/punonjësit e institucionit zhvillonin takime me të burgosurit sipas rastit brenda afatit 3(tre) ditor.

Në sektorët e regjimit të brendshëm ndodheshin edhe kuti postare ku të burgosurit mund të depozitonin ankesat/kërkesat e tyre në lidhje me institucionet e tjera jashtë sistemit të burgjeve. Për periudhën janar-prill 2023 në sekretarinë e institucionit ishin regjistruar në regjistër **187 kërkesë/ankesa nga të burgosurit**. Sipas shënimeve në regjistër, objekti i kërkesave kishte të bënte me vizita mjeksore te mjeku specialist, komunikim me skype me familjarët e tyre, kërkesa për punësim, kërkesa për takim në dhomën e prindërimit, kërkesa për blerjen e pajisjeve si TV, frigorifer etj.

Ambienti i takimeve fizike me familjarët ndodhej në një godinë më vehte, i ndarë më vehte për personat e dënuar dhe për të paraburgosurit. Në të njëjtin ambient ndodhej dhoma me kompjuter për komunikim me skype, 2 dhoma prindërimi për takimin e të burgosurve me familjarët e tyre, 8 poste për takime fizike, 2 dhoma për takime me avokatët mbrojtës dhe prokurorët, si dhe dy dhoma për takime speciale të të burgosurve familjarë.

Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua se takimet me familjarët zhvilloheshin 4 herë në muaj, nga të cilat 3 takime fizike dhe 1 takim online (kjo në varësi dhe të kërkesës të të burgosurit). Veç takimeve fizike, të burgosurit familjarë mund të zhvillonin edhe takime në dhomat e prindërimit në distancë, si dhe takimet speciale në ambientet e dedikuara për këtë qëllim.

Komunikonin me telefon i të burgosurve me familjarët zhvillohej 8 herë në muaj, sikurse është e përcaktuar edhe në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Aparatet telefonik, ishin të instaluar në korridoret e secilit sektorë në regjimin e brendshëm dhe në ambientin e ajrimit. Aparatet ishin në gjendje pune dhe nga intervistat, ata deklarorin se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë. U ngrit me shqetësim rritja fiktive e çmimit të kartës së telefonit, për shkak se, në sistemin e burgjeve operon vetëm një kompani telefonike. Ky shqetësim është ngritur në mënyrë të përsëritur edhe në IEVP-të e tjera.

Në këto kushte, vlerësojmë se DPB duhet të monitorojë me përparësi realizimin e kontratës të shërbimit telefonik në burgje sipas kushteve të miratuara mes palëve, duke riparë edhe termat e referencës të kontratës me subjektin privat që ofron këtë lloj shërbimi, për shkak të ndryshimit edhe të çmimeve të tregut që kanë ndodhur vitet e fundit. Njëkohësisht, mund të shikohet edhe mundësia e futjes në sistem e një operatori tjetër alternativ telefonik, pasi çmimi i kartës telefonike po rritet çdo vit përtej mundësive ekonomike që kanë pjesa dërrmuese e të burgosurve.

Grupi i inspektimit, verifikoi lidhjen me telefon të të burgosurve me Avokatin e Popullit nëpërmjet numrave të kontaktit që janë në dispozicion për qytetarët, por rezultoi se, nga asnjë prej aparateve telefonik nuk mund të komunikohet me institucionin tonë. Ky shqetësim, është ngritur **në mënyrë të përsëritur edhe në IEVP-të e tjera**, ndaj duhen marrë masa të përbashkëta për kapërcimin e problemeve teknike. Në ligjin nr.81/2020 dhe

në nenin 67 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve⁹, përcaktohet në mënyrë të qartë se: *“I burgosuri mund të komunikojë në telefon me Avokatin e Popullit, pa pagesë dhe në çdo kohë, bazuar në procedurat që përshkruhen në ligjin për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve. Numrat e telefonit të Avokatit të Popullit nuk përfshihen në listën e numrit të telefonit, të miratuar për çdo të burgosur”*.

Grupi i inspektimit, i kushtoi rëndësi të veçantë trajtimit të të burgosurve të grupmoshës 18-21 vjeç. Në momentin e inspektimit, në institucion ndodheshin 15 të burgosur të kësaj grupmoshe, nga të cilët 10 persona me status të paraburgosur dhe 5 të dënuar. Këta persona ishin të sistemuar në dhoma sëbashku me të burgosurit e tjerë dhe jo më vehte, në mungesë të kushteve infrastrukturore për të krijuar një sektorë të veçantë. Orari i ajrimit, për këtë grupmoshë, kryhej sipas orarit ditor të veprimeve të përcaktuar për secilin sektorë. Nga intervistat e zhvilluara, u evidentua se punonjësit e sektorit të çështjeve shoqërore zhvillonin programe sipas planit individual të trajtimit, ku përfshihet trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i tij. Avokati i Popullit vlerëson se për këta të burgosur duhet të ketë një procedurë të veçantë. Konkretisht, duhet të merret mendimi i të burgosurve për qëndrimin pranë vendbanimit dhe atij të të qenit me bashkëmoshatarët.

Lista e të punësuarve në IEVP ishte e plotësuar për 20 të burgosur, nga 32 të punësuar që janë në organikën e miratuar nga DPB-ja. Sipas informacionit, drejtuesit e institucionit nuk kishin si qëllim plotësimin fiktiv të listës së punësimit, por në vlerësimin e tyre, punësimi i të burgosurit ka si qëllim të garantojë fitimin, ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për riintegrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit. Gjithashtu, kontrata individuale e punës e nënshkruar nga i punësuarit dhe institucioni, ishte në përputhje me gjendjen shëndetësore, njohuritë dhe aftësitë për punë, formimin profesional, karakteristikat e veçanta të personalitetit, si dhe me perspektivën e riintegrit të tij në shoqëri.

Pozicionet e punës që kryenin të punësuarit, ishin të përcaktuara midis nevojës së institucionit dhe aftësive të punësuarve për secilin pozicion pune, si sanitar, punë në lavanderi, nd/kuzhiner, mirëmbajtës, berber, etj. Shpërblimi financiar ishte në përputhje me VKM nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*.

Krahas masave të ndërmarra nga institucioni, grupit të inspektimit ju paraqitën ankesa nga disa të punësuar, të cilët nuk kishin marrë pagesat mujore për punën e kryer. Nga interesimi pranë drejtuesve të institucionit, rezultoi se, fondi për të punësuarit ishte në buxhetin e institucionit, por kjo situatë ishte krijuar për shkak të mungesës të kartave ID të të punësuarve, e cila do tu jepte mundësi atyre për hapjen e numrave të llogarisë në një

⁹ Miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendim nr. 209, datë 6.4.2022 *“Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”*

nga bankat e nivelit të dytë. Pavarësisht situatës, drejtuesit e institucionit ishin të angazhuar për ti dhënë një zgjidhje sa më të shpejt, duke i pajisur ata me kartat e identitetit.

Sistemi i kamerave ishte funksional. Ato mbajnë në vëzhgim ambientet në regjimin e brendshëm dhe të jashtëm gjatë 24 orëve, pamjet e të cilave monitorohen nga salla operative e IEVP-së. Pamjet filmike ruhen në server për një afat 30 ditor dhe administrohen nga specialisti i IT.

Kushtet materiale

Infrastruktura e godinave të banimit, godinave të shërbimeve dhe vendet e ajrimit në regjimin e brendshëm të IEVP Fushë-Krujë, në tërësi plotësojnë kushtet e nevojshme për jetesë të të burgosurve, zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe sportiv, ajrimin, si dhe garantojnë elementët e sigurisë fizike për ruajtjen e jetës dhe shëndetit të të burgosurve, të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion.

Institucioni ka filluar të funksionojë në vitin 2008, por sikurse është evidentuar edhe në raportet e MKPT-së të viteve të kaluara, gjendja teknike e godinave në regjimin e brendshëm vijon të jetë jo e përshtatshme për jetesë normale, kjo për shkak të mungesës së investimeve për mirëmbajtjen e tyre, por dhe prezencës të lagështirës në këto ambiente. Sipas informacionit të drejtorit të IEVP-së, në muajin Qershor 2023 do të fillojë të zbatohet projekti për rikonstrukcionin e plotë të godinave të banimit, përmirësimin e rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë, instalimet elektrike, si dhe shkarkimin e ujrave të bardha dhe të zeza.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson hapat e ndërmarrë nga DPB-ja për kryerjen e këtij investimi, por është e domosdoshme të përshpejtohen procedurat për zbatimin e menjëhershëm të këtij projekti, pasi gjendja në të cilën ndodhen godinat e banimit, nuk garanton shëndetin dhe sigurinë e jetës të të burgosurve së tyre.

Nga inspektimi u evidentua se, dhomat e banimit janë të plotësuara me materiale fjetje si krevat, dyshek, batanie, çarçafë e jastek, sipas normativave. Edhe në sektorin e paraburgimit që kishte mbipopullim, nuk u konstatua asnjë person që të flinte me dyshekë në tokë. Nga intervistat, kishte të burgosur që siguronin materialet e fjetjes nga familjet e tyre, pasi materialet e institucionit ishin të dëmtuara dhe të vjetëruara. Sipërfaqet e dhomave të banimit janë të vogla krahasuar me numrin e personave që janë vendosur aty (kryesisht në sektorin e paraburgimit), pasi brenda sipërfaqes së dhomave, ndodhen edhe tualetet. Tualetet janë të kompletuara me nyje hidrosanitare, lavaman dhe rubineta uji. Por, dyert e tualeteve përgjithësisht ishin të dëmtuara dhe nuk mbylleshin plotësisht. Në vend të tyre të burgosurit kanë adoptuar dyer me mjete rrethore, e cila bashkë me prezencën e lagështirës, krijonte një erë të rëndë në disa ambiente banimi.

Furnizimi me ujë i ambienteve të institucionit kryhej me orar sipas grafikut, tre herë në ditë me nga 1/5 orë. Sipas të burgosurve, koha e furnizimit me ujë është e pamjaftueshme

dhe nuk përballon njëkohësisht mbajtjen e higjenës personale dhe pastërtinë e ambienteve të banimit. Të burgosurit kërkojnë të ketë furnizim pandërprerje me ujë gjatë ditës ose minimalisht të zgjatet orari i furnizimit me ujë.

Ambientet e dusheve janë të përbashkëta për secilin sektor. Në secilin ambient janë nga dy poste dushi që shërbejnë për larjen e trupit, por ato nuk përballojnë kërkesat e të burgosurve. Ngrohja e ujit të dusheve kryhet me bolier me ngrohje elektrike, të cilët ishin të rinj, por kapaciteti i tyre nuk i përballonte fluksin e të paraburgosurve për shkak dhe të mbipopullimit. Për këtë arsye, të paraburgosurit ishin detyruar që të ngrohnin ujin me rezistenca elektrike në dhomat e banimit, duke përbërë rrezik për jetën dhe njëkohësisht mbingarkojnë rrjetin e brendshëm të furnizimit me energji elektrike.

Në dhomat e banimit, dritaret janë me përmasa të tilla që lejojnë hyrjen e dritës dhe të ajrit natyral. Ambientet në regjimin e brendshëm kanë dhe ndriçim artificial që furnizohet nga rrjeti elektrik i zonës. Rrjeti i brendshëm elektrik, për shkak të mbingarkesës së linjës, herë pas here paraqiste probleme dhe kishte difekte të shpeshta në sistemin elektrik. U evidentua amortizimi i rrjetit të brendshëm elektrik, dhe në dhomat e banimit gjenden kablllo elektrik të ekspozuar në dysheme dhe që varen në mure, të cilat përbëjnë rrezik për sigurinë e jetës së të burgosurve.

Një problematikë e konstatuar në vite, është edhe mungesa e kaldajës qëndrore që të shërbejë për ngrohje/ftohjen e ambienteve të brendshme. Sipas informacionit, sistemi i kaldajës ekziston, por ajo nuk ka funksionuar që prej ndërtimit të institucionit. Në këto kushte, për periudhën e dimrit dhe të verës, me urdhër të brendshëm të drejtuesve të institucionit, lejohet përdorimi i pajisjeve elektrike për ngrohje/ftohje, të cilat sigurohen nga familjarët e të burgosurve.

Grupi i inspektimit u informua se, projekti i ri që do zbatohet për rikonstruksionin e godinave në regjimin e brendshëm, do të përfshijë edhe vënien në funksionim të kaldajës që do të garantojë ngrohjen dhe ftohjen e ambienteve të dhomave të banimit. Detyrimi i institucionit, për plotësimin e nevojave që kanë të burgosurit për jetesë normale dhe strehim adekuat, është i parashikuar edhe në ligjin e ri nr.81/2020¹⁰, si një standard i vendosur më parë nga Rregullorja Evropiane e Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Strehimi që u ofrohet të burgosurve dhe në veçanti fjetja respektojnë dinjitetin njerëzor, dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privacinë si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës dhe veçanërisht hapësirës së dyshemesë, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”*¹¹.

¹⁰ Neni 33/1 *“Mjediset që u ofrohen të burgosurve dhe në veçanti mjediset e fjetjes respektojnë dinjitetin njerëzor dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privatinë, si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës, hapësirës së nevojshme, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit”*.

¹¹ Rregulla 18.1 e Regullave Evropiane të Burgjeve.

Furnizimi i të burgosurve me produkte të higjienës si detergjente, qese plehrash, shampo, e artikuj të tjerë, kryhej sipas normativave çdo muaj nga sektori i logjistikës të institucionit. Por, të burgosurit ngrinin pretendimin se, këto normativa janë të pamjaftueshme për të përballuar nevojat që kanë të burgosurit për mbajtjen e higjienës, ndaj ata detyrohen të blinin këto materiale në njësinë tregtare ose i siguronin nga familjarët e tyre.

Në lidhje me kushtet që institucioni duhet të garantojë ndaj të burgosurve për mbajtjen e higjienës personale, larjen e trupit me ujë të ngrohtë dhe të sigurojë mjetet e nevojshme higjeno-sanitare, sjellim në vëmendjen e drejtuesve të IEVP-ve Rregullat Evropiane të Burgjeve, ku përcaktohet qartë se: *“Çdo të burgosuri duhet t’i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur dushi mund të bëhet çdo ditë ose të paktën dy herë në javë (ose më shpesh nëse është e nevojshme) në interes të higjienës së përgjithshme”*¹². Gjithashtu, në Rregullat Minimale të Trajtimit të të Burgosurve (ERM, Mandela Rules), rregulli 18¹³, të cilat jnaë pranuar si standarde tashmë nga çdo shtet, thuhet shprehimisht se: *“Të burgosurve t’u kërkohet të mbajnë pastër higjienën e tyre personale dhe për këtë qëllim ata duhet të pajisen me ujë dhe artikuj tualeti që janë të nevojshme për shëndetin dhe pastërtinë”*.

Në ambientet e banimit dhe ambientet e përbashkëta, nuk u vu re prezencë e insekteve dhe brejtësve. Por, ambientet e brendshme dhe kuzhina, për shkak edhe të lagështirës, kishin nevojë për lyerje dhe dizifektime të shpeshta, për larguar ndotjen dhe ajrin e rënduar të shkaktuar prej saj.

Lavanderia e institucionit ishte në gjendje funksionale, e pajisur me lavatriçe për larje dhe tharje të materialeve të fjetjes si batanie dhe çarçafë. Ndërsa rrobat personale, vazhdonin të laheshin nga familjarët ose nga vetë të burgosurit brenda ambientit të dhomave.

Grupi i inspektimit kontrolloi edhe ambientin e kuzhinës, kushtet higjeno- sanitare, si dhe cilësinë e gatimit të ushqimit, brenda normativave dhe menusë javore të miratuar nga drejtuesi i institucionit. Kuzhina e institucionit përbehej nga ambienti i gatimit dhe ambientet e tjera ndihmëse për vendosjen e pajisjeve frigoriferike dhe magazinave (dhomave) të furnizimit me produkteve ushqimore, të cilat ishin me hapsirë të bollshme. Stafi i kuzhinës përbehej nga 5 guzhiner dhe 6 nd/guzhiner të punësuar nga institucioni, të gjithë të pajisur me librezë shëndetësore.

Menuja ditore dhe normativat e ushqimit ishin të afishuara në një stendë, ndërsa kampionët e ushqimit ruheshin sipas vakteve ushqimore në kushte frigoriferike. Gatimi i

¹² Rregulla 19 e Regullave Evropiane të Burgjeve

¹³ Rregulla 12 Rregullave Minimale të Trajtimit të të Burgosurve (ERM, Mandela Rules)

https://static.un.org/en/events/mandeladay/mandela_rules.shtml.

ushqimit kryhej i ndarë më vete për të burgosurit dhe për të sëmurët me diabet. Sistemi i sobave të gatimit dhe ai i aspirimit, ishin funksionale. Produktet ushqimore dhe ato të mishit ruheshin në kushte frigoriferike, të ndara në ftohës dhe frigoriferë më vete. Ambienti i kuzhinës në përgjithësi ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjeno-sanitare. Transporti i ushqimit nga kuzhina për në sektorë, kryhej me enë të mëdha në karroca nga shpërndarësit e ushqimit për secilin sektorë, kurse brenda godinës, në mungesë të ashensorëve, ushqimi transportohej me krahë nga të punësuarit. Enët e kuzhinës që shërbenin për ndarjen e ushqimit, ishin të vjetëruara dhe kishin nevojë për zëvendësimin e tyre me pajisje të reja.

Pavarësisht konstatimit tonë dhe rëndësisë që i kushtonte stafi i kuzhinës gatimit të ushqimit, grupi i inspektimit mori ankesa nga të burgosurit për mungesën e larmishmërisë së ushqimit. Kjo problematikë është evidentuar vazhdimisht në rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit, por konstatojmë se ende nuk ka një përmirësim të larmisë në gatimin e vakteve ushqimore në çdo IEVP, ku sipas të burgosurve gatimi është i njëjtë dhe i pandryshueshëm çdo ditë të javës.

Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të plotësuar sipas rubrikave, të sekretuar dhe të protokolluar.

Regjimi dhe aktivitetet

Regjimi dhe aktivitetet ditore në këtë institucion zbatoheshin sipas orarit të veprimeve ditore të miratuar nga titullari i institucionit. Përsa i takon aktivitetet me karakter kulturor dhe atyre sportive, ato ishin të programuara nga sektori i çështjeve shoqërore çdo muaj dhe zhvilloheshin në bashkëpunim me punonjësit e sigurisë të institucionit.

Sektori i çështjeve shoqërore kishte në organikë 9 punonjës, të plotësuar sipas organikës, nga të cilët 1(një) përgjegjës sektori dhe 8 (tetë) specialist me profesion psikolog dhe punonjës të punës sociale.

Institucioni ka bibliotekë më vehte për sektorin e të dënuarve dhe për sektorin e të paraburgosurve. Biblotekat pothuajse nuk ishin funksionale, pasi ato kishin numër të kufizuar me libra dhe hapësira të vogla, duke mos i përmbushur kërkesat për lexim të të burgosurve. Të burgosurit pasi regjistroheshin në një regjistër nga punonjësi i bibliotekës, u hapëj kartela personale dhe më pas mund të tërhiqnin e dorëzonin librat sipas kërkesave të tyre.

E drejta e besimit dhe ushtrimit të riteve fetare, respektohej në këtë institucion. Aktivitetet fetare zhvilloheshin me pjesmarrjen e të burgosurve sipas besimeve fetare dhe përfaqësuesit të komunitetit mysliman shqiptar në Krujë (aktualisht kishte aktivitete në kuadër të muajit të Ramazanit) dhe atyre nga shoqata kristiane e të burgosurve shqiptar. Ato zhvilloheshin në mjedise të veçanta që ndodhen në regjimin e brendshëm, çdo javë sipas programit të miratuar nga drejtori i institucionit.

E drejta për arsimim dhe formim profesional është e parashikuar në legjislacionin tonë¹⁴. Në zbatim të detyrimit ligjor, institucioni në bashkëpunim me ZAV Krujë dhe kërkesave të të burgosurve, kanë hapur një klasë për zhvillimin e arsimit 9-vjeçar, e cila frekuentohej nga 16 të burgosur. Gjithashtu, institucioni në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Durrës, kanë hapur sipas interesave të të burgosurve, disa kurse profesionale si ai për “Kujdestarin Social”, “Udhërrëfim Turistik”, si dhe për specialitete hidraulik dhe elektrikist, ku ishin të regjistruar rreth 30 të burgosur, në bazë të shprehjes së interesit nga ana e tyre.

Plani individual i trajtimit ishte i hartuar nga sektori i çështjeve shoqërore të institucionit dhe ofrohej prej tyre ose në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse për shërbimet e arsimit, formimit profesional, punësimit dhe organizatat jofitimprurëse. Për të burgosurin e ri të moshës 18 deri 21 vjeç, institucioni kishte përgatitur një plan individual trajtimi, ku përfshihet trajtimi, rehabilitimi dhe riintegrimi i tij. Vlerësimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhej nga personeli i sektorit të edukimit në bashkëpunim dhe me sektorët përkatës të institucionit.

Dosjet personale të të burgosurve ishin të plotësuara rregullisht sipas rubrikave, me përmbledhje nga takimet më vehte me të dënuarit dhe të paraburgosurit, programet individuale të trajtimit në të cilat ata kishin marrë pjesë, vlerësimet sipas tre mujoreve dhe gjithë dokumentet e tjera mbështetëse, për llojin e asistencës së ofruar psikologjike, sociale apo mjekësore. Në dosjet psiko-sociale ishin të evidentuara edhe niveli i rrishtit referuar gjendjes psiko-emocionale që paraqiste çdo i burgosur, si dhe kohëzgjatja e trajtimit në varësi të qëndrueshmërisë së mendimeve dhe sjelljeve që ata reflektonin gjatë kohës të qëndrimit në këtë institucion.

Tërësia e aktiviteteve të zhvilluara dhe e trajtimeve psiko-sociale individuale dhe në grup me të burgosurit në këtë institucion, kishin si objektiv rehabilitimin, këshillimin dhe mbështetjen psikologjike të tyre, me qëllimin final ri-integrimit në shoqëri të kësaj kategorie pas përfundimit të periudhës së vuajtjes së dënimit.

Pavarësisht masave të marra në planifikimin e aktiviteteve, ky komponent rezulton të ketë mangësi jo vetëm në IEVP Fushë Krujë, por në tërë sistemin penitenciar, pasi gjendja psiko-sociale e të burgosurve nuk rezulton të jetë e mirë, ndaj mbetet shumë punë për të bërë të mundur arritjen e qëllimit final, atë të riintegritimit dhe rehabilitimit të të burgosurve.

Shërbimi shëndetësor

¹⁴ Neni 45 i ligjit nr.81/2020: “Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhen me anë të organizimit të programeve arsimore, si dhe të kurseve profesionale, sipas legjislacionit në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar dhe legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional”.

Organika e sektorit shëndetësor në I EVP Fushë-Krujë përbëhet nga 9 punonjës, nga të cilët 2 mjek (i përgjithshëm dhe psikiatër), 1 farmacist, 1 stomatolog dhe 5 infermierë. Në momentin e inspektimit, në këtë sektor kishte mungesë të 1 (një) infermieri, ndërsa mjekët njëri prej tyre ishte i punësuar me kohë të plotë dhe një ishte i punësuar me kontratë me kohë të pjesëshme. Mjeku stomatolog dhe farmacisti ishin të punësuar me kohë të plotë.

Në regjimin e brendshëm të I EVP-së, u evidentua se ndodhej ambienti i infermierisë që përbëhet nga dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave, dhoma e stomatologut, farmacia, dhoma e urgjencës ku kryejnë shërbimin 24 orë stafi i infermierëve, si dhe 8 dhoma shtrimi. Dhoma e mjekut ishte e kompletuar me orëditë e nevojshme si tavolinë pune, karrige, raftë për mbajtjen e medikamenteve, kartelave mjekësore individuale për çdo të burgosur dhe regjistrat mjekësorë.

Po ashtu, dhoma e stomatologut ishte funksionale dhe e pajisur me karrige, sterilizues, si dhe njësinë dentare, e cila përballonte kërkesat e të burgosurve për vizitë apo kontroll mjekësor. Në rastet e ndërhyrjeve kirurgjikale dhe mbushjeve të dhëmbëve, që nuk mund të kryheshin nga stomatologu i institucionit, me kërkesë të të burgosurve dhe rekomandimit të mjekut të institucionit, pas miratimit nga drejtuesi i institucionit, i burgosuri shoqërohej për në klinikat private në qytetin e Krujës, me shpenzimet që mbulohej nga vetë i burgosuri ose familjarët e tij.

Nga inspektimi u evidentua se, në dhomat e infermierisë të institucionit nuk ndodhej asnjë i burgosur i sëmurë apo i shtruar me rekomandimin e mjekut, ndërsa gjëndja shëndetësore e të burgosurve, paraqitej si me poshtë vijon:

- 12 pacientë me probleme kardiake dhe me HTA, si dhe 2 pacientë të sëmurë kronik, të përfshirë në skemën e ribursimit;
- 5 pacientë të sëmurë me diabet;
- 12 pacientë të sëmurë me probleme të shëndetit mendor;
- 13 pacientë përdorues të “methadone”.

Shërbimi shëndetësor për të burgosurit dhe të sëmurët kronikë, ofrohej nga personeli shëndetësor i institucionit, por në rastet e urgjencave të sëmurët shoqëroheshin për mjekim më të specializuar në Spitalin e qytetit të Krujës dhe në QSB Tiranë. Shoqërimi i të sëmurëve për në spital, kryhej nga autoambulanca e institucionit, e cila ishte në gjendje të mirë teknike.

Pacientët e burgosur me probleme të shëndetit mendor mbahen nën kontroll nga mjekët psikiatër që vinin sipas grafikut nga Spitali i Burgjeve në Tiranë. Personeli i infermierëve të institucionit, u jepte terapinë këtyre shtetasve sipas rekomandimeve të lëna nga mjekët psikiatër, duke qenë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mbikqyrnin me rigorozitet administrimin e tyre.

Grupi i inspektimit, konstatoi se shërbimi shëndetësor ndaj të burgosurve nuk ishte ndërprerë në asnjë moment, por në intervista me të burgosurit, një pjesë e tyre ngrinin si shqetësim vonesat në kryerjen e vizitave mjekësore te mjekët specialist, pasi në spitalin e Krujës kishte mungesa të mjekëve. Ankesa u paraqitën edhe ndaj shërbimit stomatologjik të institucionit, për zvarritje të kërkesave të të burgosurve për ndërhyrje kirurgjikale dhe ekstraksioneve pranë klinikave private.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, vonesat në kryerjen e vizitave mjekësore të të burgosurve të sëmurë te mjekët specialist apo klinikat private shëndetësore, përbëjnë një të drejtë e mohuar nga ana e institucionit ndaj të burgosurve. Vlerësimi i Avokatit të Popullit, është i njëjtë me qëndrimet e mbajtura nga KPT(CPT)¹⁵, në vizitën inspektuese që ka kryer në Shqipëri në vitin 2018. Në raportin me rekomandime drejtuar autoriteteve të Qeverisë Shqiptare, në lidhje me përmirësimin e cilësisë të këtij shërbimi ndaj të burgosurve, ka rekomanduar duke theksuar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre”*, dhe se, *“shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*.

Vlerësimi i Avokatit të Popullit dhe qëndrimi i KPT-së, janë gjithashtu dhe në përputhje me standardin e miratuar në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹⁶.

Ambientet e infermierisë si dhoma e mjekut, e stomatologut dhe farmacia ishin të lyera dhe në kushte të mira higjieno-sanitare.

Nga kqyrja e dokumentacionit të sektorit shëndetësor, në dhomën e mjekut dhe dhomën e urgjencave ndodheshin kartelat klinike të të burgosurve, regjistri i vizitave mjekësore, regjistri i kufizimeve fizike, regjistri i shërbimit 24 orësh të infermierëve, si dhe regjistri i shpërndarjes të medikamenteve mjekësore për të sëmurët kronikë. Këto dokumente ruheshin në rafte të veçantë, ishin të sekretuar dhe ishin të plotësuara sipas protokolleve shëndetësore.

Nga kqyrja e regjistrit për rastet e dëmtimeve fizike të të burgosurve apo përdorimit të dhunës, nuk u konstatua asnjë ngjarje e evidentuar apo e referuar nga personeli shëndetësor i institucionit ndaj tyre.

¹⁵ Komiteti për Parandalimin e Torturës

¹⁶ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Theksojmë se, institucioni ishte i furnizuar me sasinë e nevojshme të medikamenteve të urgjencës dhe për të sëmurët kronikë, të cilat shpërndareshin nga stafi shëndetësor i infermierëve, sipas rekomandimit të mjekëve specialist. Gjithashtu, të burgosurit ishin të pajisur me librezat shëndetësore, e cila e shoqëronte të burgosurin gjatë transferimeve nga njëra IEVP në tjetrën.

Skema e rimbursimit të ilaçeve për të sëmurët kronikë, funksiononte sipas kontratës tre palëshe të lidhur mes FDSKSH-së, depos farmaceutike dhe institucionit, e cila i referohej historikut të sëmundjeve për çdo të dënuar dhe të burgosur, si dhe kartelave shëndetësore të të burgosurve të plotësuar nga mjeku i institucionit në. Njëkohësisht, furnizimi me ilaçe i institucionit kryhej periodikisht nga sektori i shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe blerjes së drejtëpërdrejtë të medikamenteve me fondet e akorduara në buxhetin e institucionit.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, ku parashikohet midis të tjerash se: *“Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

REKOMANDOJMË:

1. Të merren masa të menjëhershme nga DPB, për miratimin e Rregullores së Brendshme të IEVP Fushë Krujë.
2. Të merren masa të menjëhershme nga sektori juridik dhe sektori i policisë të institucionit, për pajisjen me karta identiteti të punësuarve që nuk kanë mundur të hapin numrat e llogarisë në bankë, me qëllim shpërblimin financiar të tyre, sipas kriterëve të përcaktuara në VKM-në nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*.
3. Të vijojnë në mënyrë të përsheptuar, procedurat për zbatimin e menjëhershëm të projektit për rikonstruksionin e plotë të godinave në regjimin e brendshëm të këtij institucioni, pasi në gjendjen në të cilën ndodhen, nuk garantojnë ruajtjen e jetës, shëndetit dhe sigurinë e të burgosurve.

4. Të merren masa të menjëhershme për afishimin e numrave të telefonit të Avokatit të Popullit dhe organizatave jo qeveritare që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe vënien në efikasitet të numrave të telefonit për komunikimin me Avokatin e Popullit, në lidhje me adresimin në kohë të shpejtë të ankesave apo pretendimeve për shkeljen e të drejtave të tyre të ligjshme.
5. Të merren masa organizative nga DPB për përcaktimin e kapacitetit fizik të IEVP Fushë-Krujë dhe IEVP-ve të tjera, duke respektuar parametrat teknikë të godinave, me qëllim garantimin e standartit të miratuar në aktet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, për sipërfaqen dhe kubaturën e lejueshme për çdo person në dhomat e banimit.
6. Të merren masat e nevojshme në bashkëpunim me DPB, për eliminimin e mbipopullimit në sektorin e paraburgimit në IEVP Fushë Krujë, pasi qëndrimi për një kohë të gjatë, çënon rëndë kushtet e jetesës të të burgosurve dhe përbën trajtim jo dinjitoz e degradues të tyre.
7. Të merren masat e nevojshme organizative, për plotësimin e vendit vakant të zv/drejtorit, përgjegjësit juridik, infermierit dhe punonjësve të policisë, sipas strukturës organike të miratuar.
8. IEVP Fushë Krujë të marrë masat të nevojshme në bashkëpunim me UK Krujë, për përmirësimin e situatës të furnizimit me ujë pa ndërprerje të ambienteve në regjimin e brendshëm ose të gjejnë zgjidhje alternative për zgjatjen e orarit të furnizimit me ujë, me qëllim sigurimin e higjienës personale të të burgosurve, si dhe pastërtinë në dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta.
9. Të marren masa e nevojshme në kuadër të rikonstruksionit të godinave të banimit, për vënien në funksion të kaldajës qendrore për ngrohje/ ftohjen e ambienteve në regjimin e brendshëm, si dhe riparimin e instalimeve elektrike dhe hidraulike.
10. Të merren masat e nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për kryerjen e një studimi mbi kapacitetet e nevojshme për ofrim më cilësor të shërbimit telefonik të të burgosurve me familjarët e tyre. Të rishikohet kontratat me subjektin që ofron aktualisht shërbimin e telefonave në sistemin e burgjeve, si dhe shtimin e numrit të operatorëve privatë.
11. Të merren masa të menjëhershme, për zëvendësimin e materialeve të fjetjes të vjetëruara në dhomat e banimit me pajisje hotelerie të reja, si dhe kompletimin me orenditë nevojshme si karrige për qëndrimin ulur dhe komodina për mbajtjen e sendeve personale dhe të ushqimeve.
12. Të merren masa të menjëhershme për furnizimin e bibliotekave të institucionit me libra të rinj dhe vënie në funksionim të plotë të saj, me qëllim rritjen e interesit të të burgosurve për leximin.

13. Të merren masa të menjëhershme, për dhënien e një shërbimi shëndetësor efikas dhe dinjitoz pacientëve që kanë probleme shëndetësore, si dhe nevojës për të kryer vizita mjekësore te mjekët specialistë, pranë qendrave spitalore por edhe në QSB Tiranë.
14. Të udhëzohet marrja e një miratimi/mendimi me shkrim prej të burgosurve nën 21 vjeç, nëse nuk ka në burgun më afër vendbanimit, sektorë të posaçëm për 18 – 21 vjeç.
15. Të merren masat e nevojshme, për plotësimin e organikës të sektori shëndetësor me 2 (dy) mjekë me kohë të plotë.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA